- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara Nenin 45/1 të LPP.
- Personi/at në cilësinë e ***anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik***, si më poshtë:

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_ etj.

nuk janë ose kanë qenë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në nenin 45/1 të LPP<sup>1</sup>.

- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).
- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

**Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.**

**Data e dorëzimit të deklaratës** \_\_\_\_\_

**Nënshkrimi i ofertuesit** \_\_\_\_\_

**Vula** \_\_\_\_\_

**Shtojca 7/1**

[ *Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik* ]

**DEKLARATË MBI GARANTIMIN E ZBATUESHMËRISË SË DISPOZITAVE  
LIGJORE NË MARRËDHËNIET E PUNËS**

Deklaratë e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë \_\_\_\_\_ nga Autoriteti Kontraktor \_\_\_\_\_ me objekt \_\_\_\_\_ me fond limit \_\_\_\_\_.

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_ me cilësinë e \_\_\_\_\_ të operatorit ekonomik \_\_\_\_\_, **deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:**

- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.
- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.
- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.

**Data e dorëzimit të deklaratës** \_\_\_\_\_

**Përfaqësuesi i ofertuesit**

**Nënshkrimi**

**Vula**

**Shtojca 8**

[ *Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor* ]

**1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT**

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.

b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)

c) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,

ç) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.

d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.

**Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.**

**Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 7.**

**Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.**

**Vec kesaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet te dorezohen:**

**a.** Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;

**b.** Prokura e posaçme.

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

*a. Formulari i Ofertës, sipas Shtojcës 1;*

*b. Deklaratën për paraqitje oferte të pavarur, sipas Shtojcës 1/1*

*c. Sigurimi i ofertes, (nëse është i zbatueshëm) sipas Shtojcës 3;*

*ç. Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 5;*

*d. Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit, sipas Shtojcës 6;*

*dh. Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës sipas Shtojcës 7/1;*

*e. Vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.*

3. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

### **2.1. Kapaciteti ligjor i operatorëve ekonomikë:**

Objekti i Prokurimit ose ekuivalent me te duhet të jetë i pasqyruar në ekstraktin e gjendjes

aktuale të shoqërisë, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit, në objektin e veprimtarisë së operatorit ekonomik.

## **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.2.1 Xhiro mesatare financiare vjetore, e realizuar nga Operatori Ekonomik ne tre vitet e fundit 2016, 2017 dhe 2018, duhet te mos jete me e vogel se 40% e fondit limit te procedurës se prokurimit (4 940 849 leke).

*Per te vertetuar plotesimin e ketij kushti Operatori Ekonomik duhet te paraqese nje vërtetim nga Dega e Tatim Taksave për xhiron vjetore të realizuar në 3 (tre) vitet e percaktuar me sipër:*

2.2.2 Operatori Ekonomik duhet te mos kete bilanc me humbje gjate vitit te fundit 2018.

*Per te vertetuar plotesimin e ketij kushti Operatori Ekonomik duhet te paraqese kopje të bilancit të vitit të fundit 2018, të paraqitur pranë autoritetit përkatëse, të konfirmuara nga ky autoritet.*

## **2.3 Kapaciteti teknik:**

2.3.1 Operatori Ekonomik duhet te kete realizuar sherbime të ngjashme në një vlerë jo më pak se 40% e fondit limit qe prokurohet (4 940 849 leke) dhe që është realizuar me sukses gjatë tri viteve të fundit;

*Operatori ekonomik si dëshmi për përvojën e mëparshme nga një ent publik duhet te paraqesi :a) Vertetim nga institucioni ku eshte kryer sherbimi, b) fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara*

*Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi operatori ekonomik duhet te paraqesi: fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.*

2.3.2 Operatori Ekonomik duhet të ketë nje punesim mesatar, me jo më pak se 30 punonjes, për periudhën (01 janar 2019 – 30 qershor 2019), e vërtetuar kjo me : *Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për periudhën e kerkuar, shoqeruar me formularët E-SIG 025 te konfirmuara nga organet perkatese (me nenshkrim elektronik ose ne hard copy).*

2.3.3 Operatori Ekonomik duhet te vertetoje se disponon kualifikimet e duhura te stafit drejtues perkates per kryerjen e te gjitha punimeve ne kete objekt:

*a) Operatori ekonomik duhet te paraqese dokumentacion se ka si te punesuar dhe te regjistruar per periudhen (01 janar 2019 – 30 qershor 2019), ne kompanine e tij minimalisht:*

- 1 (nje) Inxhinier Ndërtimi
- 1 (një) Inxhinier Gjeodet
- 1 (nje) Inxhinier Mjedisi

të shoqëruara për secilin punonjës me diplomë, kontratë pune dhe CV.

*b) Operatori ekonomik duhet te paraqese dokumentacion se ka si te punesuar dhe te regjistruar*

*ne kompanine e tij 1 (nje) Inxhinier Ndërtimi te specializuar per IRI (International Roughness Index) & FWD (Falling Weight Deflectometer) i pajisur me certifikata deshmuere. Per kete duhet te paraqiten kontratë pune diplome, libreze pune, cv si dhe certifikatat deshmuere.*

- c) *Operatori ekonomik duhet te paraqese dokumentacion se ka si te punesuar dhe te regjistruar per periudhen (01 janar 2019 – 30 qershor 2019), ne kompanine e tij 1 (nje) Auditues Mjedis, i pajisur me certifikate leshuar nga Ministria e Mjedisit per “Vleresimin e ndikimit ne mjedis dhe auditim mjedisor”. Per kete duhet te paraqiten kontratë pune diplome, libreze pune, cv dhe certifikata.*

*2.3.4 Operatori Ekonomik duhet te deklaroje me shkrim se inxhinieret dhe punonjesit e kerkuar ne piken 2.3.3 per kualifikim jane te paangazhuar ne kontrata te tjera.*

2.3.5 Operoret ekonomike duhet te disponojne licensat e nevojshme per zbatimin e kontrates. Per kete duhet te paraqesin licensen perkatese te shoqerise, bazuar ne formatin e miratuar me Vendim te Keshillit te Ministrave Nr. 42 date 16.01.2008, ”Per miratimin e rregullores per kriteret dhe Procedurat e dhenies se licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te Subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi”. Shqyrtimi i licensave do te behet mbi bazen e rregullave te parashikuara ne sa me siper. Licensa profesionale e Operatorit Ekonomik lidhur me ekzekutimin e puneve te kontrates duhet te permbaje kategorite e meposhtme:

- NP – 1/A Punime germimi ne toke.
- NP – 4/A Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale.
- NP – 5/A Punime nentokesore, ura e vepra arti.
- NP – 12/A Punime të inxhinierisë së mjedisit.
- NS – 6/A Sinjalistika rrugore jo ndriçuese.
- NS – 7/A Bariera dhe mbrojtje rrugore.

*Shoqëritë e huaja duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, ne Republiken e Shqipërisë.*

2.3.7 Operatori ekonomik duhet te disponoje mjetet dhe paisjet e nevojshme teknike per realizimin e kontrates. *Per kete duhet te paraqese deshmi per mjetet dhe paisjet teknike qe ka ne dispozicion apo mund t’i vihen ne dispozicion operatorit ekonomik.*

Kerkohen te jene ne dispozicion keto mjete pune:

| Nr | Lloji i Makinerive   | Pronësia               | Sasia  |
|----|----------------------|------------------------|--------|
| 1  | Kamion vetëshkarkues | në pronësi ose me qira | Copë 2 |
| 2  | Grejder              | në pronësi ose me qira | Copë 1 |
| 3  | Asfaltoshtruese      | në pronësi ose me qira | Copë 1 |
| 4  | Rrul vibrues         | në pronësi ose me qira | Copë 1 |

## Dokumentat standarde të tenderit

|    |                                               |                                             |        |
|----|-----------------------------------------------|---------------------------------------------|--------|
| 5  | Autobitumatriçe                               | në pronësi ose me qira                      | Copë 1 |
| 6  | Eskavatore fadrome                            | në pronësi ose me qira                      | Copë 1 |
| 7  | Eskavator me Goma                             | në pronësi ose me qira                      | Copë 1 |
| 8  | Kamioncine                                    | në pronësi ose me qira                      | Copë 2 |
| 9  | Pajisje per matje IRI & FWD                   | në pronësi ose me qira                      | Cope 1 |
| 10 | Fabrike asfaltobetonit (QKL & Leje mjedisore) | në pronësi / me qira ose kontrate furnizimi | Copë 1 |

- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit lëshuar nga DPSHTRR (leje qarkullimi), certifikata e vlefshme e kontrollit teknik, siguracioni i vlefshëm i mjetit dhe fotot e tyre.

- Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes / cdoganimi në RSH (ose kalimi me regjim të perkohshëm), fotot dhe fatura tatimore perkatese.

- Për pajisjet teknike, kur janë në pronësi, duhet të paraqiten faturat tatimore të shitjes dhe kontratat e shitblerjes. Kur janë me qera duhet të paraqiten kontratat noteriale e qerash, faturat tatimore të shitjes dhe kontratat e shitblerjes. Faturat që nuk janë sipas formatit të miratuar me tvsh (faturat e biznesit të vogël) duhet të shoqerohen me kuponin tatimor. Duhet të paraqiten fotot e tyre.

Kur mjetet / pajisjet teknike janë me qera, duhet të paraqitet kontrata noteriale e qerash, dhe bashkëlidhur të gjithë dokumentet e përshkruar në paragrafët 1, 2 dhe 3, sipas perkatesise.

Fabrika asfaltobetonit duhet të jetë e montuar në gjendje pune dhe e instaluar në një vendndodhje jo më larg se 60 km nga objekti (mjafton nga një pikë e rrugëve që mirembahen nga Kontrata). Ajo duhet të jetë e pajisur me QKL dhe leje mjedisore. Ofertuesi duhet të deklarojë vendndodhjen e saktë të fabrikës së asfaltobetonit të montuar (nuk pranohet deklarate levizje impianti), të paraqesë planin e vendosjes të fabrikës së asfaltobetonit dhe të paraqesë fotografi të fabrikës së asfaltobetonit të montuar në vendndodhjen e deklaruar.

**Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë vertetësinë e deklaratës. Në rast deklarimi të rreme do të veprohet në përputhje me nenin 13, pika 3, germa "a" të Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, "Per Prokurimin Publik".**

2.3.8 Makinerite e mesiperme nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata të tjera. Për këtë të paraqitet një deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese se makinerite e mesiperme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera.

**Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë vertetësinë e deklaratës. Në rast deklarimi të rreme do të veprohet në përputhje me nenin 13, pika 3, germa "a" të Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, "Per Prokurimin Publik".**

2.3.9 Operatori Ekonomik duhet të disponojë dhe paraqesë certifikatat:

- EN-ISO 9001:2015 (Sistemi i menaxhimit të cilësisë)
- ISO 39001 : 2012 (Certifikate e Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë në trafikun

*rrugor)*

- EN-ISO 14001:2015 (*Sistemi i menaxhimit të mjedisit*)
- BS OHSAS 18001:2007 (*Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë*)

*Nese ofertuesi do te paraqitet si bashkim operatorësh, certifikatat duhet te paraqiten nga secili operator ekonomik.*

2.3.10. Operatorët e huaj ekonomikë, duhet të paraqesin të gjithë dokumentacionin e tyre në gjuhën shqipe (si gjuhë e ofertës), të bëjnë noterizimet përkatëse si dhe të jenë të certifikuar “Apostille”. Për vendet që nuk kanë ratifikuar Konventën e Hagës datë 5 tetor 1961, “Për heqjen e kërkesës për legalizim diplomatik e konsullor të dokumenteve zyrtare të huaja”, duhet të bëhen legalizimet në ambasadat, konsullatat ose zyrat respektive nga vendi i origjinës.

2.3.11. Kandidatët/ofertuesit duhet të përmbushin kërkesat ligjore të parashikuara në nenin 45 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar. Në rastin e Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë, kandidatët/ofertuesit duhet t’i përmbahen VKM-së nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.3.12. Nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomik, duhet të dorëzohen marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht dhe Prokura e posaçme. Çdo anëtar i grupit, duhet të dorëzojë dokumentat e kërkuara, në përputhje dhe përputhje me punët e marra për sipas marrëveshjes së bashkëpunimit.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

## **Shtojca 9**

[ *Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor* ]

### **SPECIFIKIMET TEKNIKE**

**(Specifikimet Teknike janë të bashkelidhura me DST)**

#### **KUJDES**

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të

kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

## **RELACION TEKNIK**


**Aksi rrugor:**Berat -Corovode

**Gjatësia:** 49,3 km

**Gjerësia:** 6 m(mesatare)

**Pika e Fillimit:** Qender Berat **km 0** (40°42'59" N - 19°57'20" E)

**Pika e Mbarimit:** Qender Corovode **km 49,3** (19 ° 57'20" N - 20° 13'30" E)



### **Vendodhja e aksit rrugor Berat-Corovode 49,3km.**

Aksi rrugor Berat -Corovode kalon ne nje terren kryesisht kodrinor –malor ,kalon pergjate lugines se lumit,,Osum,, dhe eshte alternativa e vetme rrugore nacionale qe lidh Rrethin e Beratit me rrethin e Corovodes .

**Fillon** ne piketen 0 ne qender Berat (Sheshi ne qender te qytetit). Vazhdon permes zonave te banuara te fshatrave: Vodice,Hoxhaj,Gradisht,Fushe Peshtan,Vertop,Mbrakull,Plirez(Rrethi

Berat) ,me tej ne qytetin e Policanit, dhe vazhdon perseri permes zonave te banuara te fshatrave: Pronovik,Bogove,Kakruke,Orizaj,Buzuq,Munushtir (Rrethi Skrapar).

**Perfundon** ne qender Corovode (Sheshi ne qender te qytetit).

**Pershkrimi e aksit rrugor Berat –Corovode 49,3km.**

Aksi rrugor Berat –Corovode me gjatesi 49,3km eshte ne gjendje te kenaqeshme .Ky aks fillimisht eshte ndertuar para viteve 1930 me gjeresi te kufizuar (3m) .Me vone gjate viteve 1950-60 eshte bere zgjerimi i rruges dhe mbas viteve 75 jane ndertuar veprat e artit(mure mbajtese,prites,ura,tombino) dhe ka filluar shtrimi me asfaltobeton i saj.

Mbas viteve 90 jane bere investime te pjeseshme kryesisht ne shtresat rrugore dhe ne veprat e artit . Eshte aks rrugor me nje karexhate dhe me dy kahe levizjeje.

**-Shtresat rrugore** aktualisht jane te shtruara me asfaltobeton.Ne shtresen rrugore ne segmentin Berat-Polican gjithë rruga ,duke filluar ne dalje e lagjes Uznove (km 5) deri ne hyrje te qytetit te Policanit(km23) paraqitet me demtime te konsiderueshme te shtreses asfaltike te llojit:**Rrjetezime, gropezime te vogla dhe te medhaja,si dhe cedime te dukshme.** Me te pakta jane demtimet e shtreses asfaltike ne segmentin Polican –Corovode.

**-Kanalet anesore** .Terreni i thyer dhe malor ne te cilin kalon rruga krijon gjithmone rreshqitje dherash,aluvione dhe renie guresh,si rrjedhim mbushja e kanaleve anesore eshte shume e shpejte.Ne kushte ku dhe permasat e kanaleve anesore nuk jane optimale ,duhet pastrimi periodik i tyre.

**-Bankinat** jane me permasa minimale pothuajse ne te gjithë gjatesine e rruges,per aresye te njejta te pershkruara me sipër duhen mirembajtur ne menyre periodike. *Pasi e gjithë rruga kalon ne zona te banuara dhe ka nje me fluks te perditeshem kembesoresh.*

**-Bimesia** eshte prezente ne te gjithë gjatesine e rruges.Eshte e llojit shkurre dhe pisha.Keto te fundit rrezikojne rrugen pasi ndodhen shume prane saj.Kontrollet periodike te rruges duhen bere ne menyre te eliminohen rreziqet e rruges nga renia e pishave(zona e Bogoves).

**-Sinjalistika** .Rruga eshte e pajisur me disa tabela me shenja rrugore normale. Aktualisht sinjalistika vertikale e vendosur ne rruge eshte me demtime(Tabela dhe pervijues te demtuar).Eshte e nevojshme vendosja e pervijuesve ne te gjithë gjatesine e rruges dhe shtimi i tabelave te reja treguese ,normale.

**-Vepra arti** .Rruga ka shume vepra arti te llojeve tombino ,ura dhe mure mbajtes,prites.Ne pergjithesi keto vepra arti jane ne gjendje te mire.Por kerkohet mirembajtja dhe kontrolli periodik i urave dhe tombinove ne gjithë elementet perberes te tyre.Gjithashtu dhe i veprave te tjera te artit.

**-Trafiku** .Ne kete rruge ka nje trafik ne nivel mbi mesatar .Theksojme se ka nje fluks te mjetesh me tonazh te rende. Trafiku i mjeteve te tonazheve te renda ne kete rruge eshte me nje fluks te madh dhe me kapacitete jashte normave te lejuara per standartin aktual te kesaj rruge.

**PROBLEMATIKAT NE AKSIN RRUGOR BERAT-COROVODE me gjatesi 49,3km:**

**-Amortizimi i shtresave rrugore.**Eshte shume problematike gjendja e shtresave rrugore kryesisht ne segmentin Berat-Polican.Sidomos zonat: Vodice,Hoxhaj,Gradisht,Mbrakull.

**-Rreshitja e dheut dhe e gureve.**Ne zonen e Cesmes Thate ,ne zonen e Bogoves,ne zonen e Rripit te Stiores ka rreshqitje te konsiderueshme te dherave dhe gureve,si pasoje e terrenit te pjerret,prania e burimeve nentoksore dhe zona te zhveshura nga bimesia.

**-Bimesia** .Prania e bimesise dhe kryesisht e pishave shume prane rruges eshte nje faktor rreziku per sigurine rrugore.Zonat me te rrezikuara jane zona Gradisht,zona Mbrakull dhe zona e Bogoves.

**-Kthesat e forta.**Si rezultat i terrenit ku rruga kalon ka zona me kthesa te forta dhe pamje te kufizuar.Zonat me te rrezikshme jane Gradisht,Vertop,Mbrakull,Pronovik,Bogove,Kakrruke.Pajisja me sinjalistike dhe prerja e bimesise duhet te jene me te kujdeshme ne keto zona. Eshte e nevojshme pajisja me pervijuese e rruges ne keto zona.

**-Prania e bores dhe akullit.**Eshte nje faktor i pranishem ne stinen e dimrit ne disa zona te ketij aksi rrugor. Prania akullit eshte e perhershme ne stinen e dimrit ne zonen e Bogoves,zona e hijeve te Kakrrukes.Gjithashtu ka dhe rreshje debore te pranishme ne zonen Bogove-Corovode. Kontrata e Mirembajtjes nuk permban Mirembajtje Dimerore, megjithate Kontraktori eshte i detyruar te marre masa per zgjidhjen e problemeve qe shkaktohen nga ngricat, akulli e debora ne kete aks.

**Shenim:**

Kontraktori i mirembajtjes duhet ti mbaje ne monitorim te vazhdueshem zonat me problematiken e mesiperme ne vecanti dhe gjithe rrugen ne pergjithesi.

**Shtojca 10**

[ Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në marrëveshjen kuadër]

**PLANIFIKIMI I  
KONTRATAVE NË MARRËVESHJEN KUADËR**

| <p style="text-align: center;">Shërbim:<br/>Numri total i kontratave sipas Marrëveshjes Kuadër</p> |                            |                                         |
|----------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------|-----------------------------------------|
| <b>Kontrata<br/>Nr.</b>                                                                            | <b>Titulli i Kontratës</b> | <b>Përshkrim i shkurtër i kontratës</b> |
| <b>01</b>                                                                                          |                            |                                         |
| <b>02</b>                                                                                          |                            |                                         |
| <b>03</b>                                                                                          |                            |                                         |
| <b>...</b>                                                                                         |                            |                                         |

## **Shtojca 11**

*( Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)*

*(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)*

## **SHËRBIMET DHE GRAFIKU I EKZEKUTIMIT**

**Shërbimi që kërkohet:** “Mirembajtje rutine me performance aksi rrugor Berat – Corovode 49,3 km”

## Dokumentat standarde të tenderit

Afatet e ekzekutimit: 12 muaj

## Shtojca 12

( Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

### **TERMAT E REFERENCËS**

**OBJEKTI** : “Mirembajtje rutine me performance aksi rrugor Berat – Corovode 49,3 km”

**PERFITUESI** : Drejtoria e Rajonit Jugor Gjirokaster.  
Adresa : Zona Industriale Gjirokaster.  
Tel : 084262529.

**HISTORIKU** : Aktiviteti i mirembajtjes se rrugeve nacionale perpara vitit 2013 realizohej nga vete Drejtoria nepermjet Sektoreve te Mirembajtjes me fuqi punetore dhe me makineri. Pas vitit 2013 Mirembajtja e Rrugeve realizohet nepermjet Kontratave te Mirembajtjes Rutine e Dimerore me Performance. Keto Kontrata perbejne nje model te ri te menaxhimit te aktivitetit te mirembajtjes se rrugeve. Mirembajtja e rrugeve tani realizohet nepermjet Kontratave te Mirembajtjes Rutine e Dimerore me Performance. Keto kontrata fillimisht ne vendin tone jane aplikuar nga Banka Boterore per nje periudhe 5-vjecare. Pas perfundimit te ketij projekti ky model kontratash eshte percjelle ne Drejtorine e Pergjithshme te Rrugeve dhe ne Drejtorite Rajonale Rrugore per tu zbatuar ne te ardhmen.

Aplikimi i ketyre Kontratave perben nje projekt strategjik per te ardhmen ne fushen e menaxhimit te aktivitetit te mirembajtjes se rrugeve nacionale. Keto lloj kontratash jane perdorur dhe kane rezultuar te suksesshme ne disa vende te Bashkimit Evropian. Duke u mbeshtetur ne kete eksperience te suksesshme dhe me asistencen teknike te partnereve nderkombetare keto lloj kontratash kane filluar te zbatohen edhe ne vendin tone.

**OBJEKTIVAT, QELLIMI, REZULTATET E PRITSHME** : Keto kontrata ndryshojne nga kontratat e zakonshme , bazohen ne performance, ne arritjen e niveleve dhe standarteve te caktuara dhe bazohen ne pagesa mujore per plotesimin e standarteve. Zerat e ketyre punimeve nuk jane me mase njesi me sasi punimesh te vleresuara te bazuara ne nje projekt dhe ne nje cmim njesi por jane pagesa mujore te bazuara ne arritjen e nje standarti.

Tipi standart i kontrates se inxhinierise se ndertimit eshte ajo me mase njesi me sasi punimesh te vleresuara te bazuara ne nje projekt dhe ne nje cmim njesi per te kryer sasite e vleresuar sipas cdo zeri pagese. Kontratat e bazuara ne efektivitet paraqesin nje tip me te avancuar kontraktimi kryesisht per perdorim ne kontraktime mirembajtjeje dhe bazohen ne cka kerkojne ne fund perdoruesit, qe d.m.th. nivele standarte te caktuara fillimisht me pagesa te bazuara ne shuma vjetore apo mujore ne total te plotesojne keto standarte.

Pra Sipermarresi duhet te arrije standartet e kerkuara qe rruga te mos kete gropa, te sigurohet rrjedhja e lire e ujit ne anet e rruges, tombinot te jene funksionale, ne rruge te mos kete aluvione, depozitime te ngurta inerte, te kete siguri rrugore sa me te larte etj. Mirembajtja rutine

konsiston ne shume detyra te ndryshme per tu kryer shpesh per te mbajtur funksionin e rruges. Per akset rrugore qe kane nevoje per mirembajtje dimerore nga Sipermarresi kerkohet te mos bllokohet aksi rrugor nga debora e ngricat, te sigurohet nje qarkullim sa me normal dhe pa rreziqe te automjeteve, te kryhen punime per pastrimin e debore, te mos lejohet formimi i akullit dhe ngricave (sa te jete e mundur) etj.

**SUPOZIMET DHE RISQET** : Ne ecurine normale te zbatimit te Kontratave te Mirembajtjes Rutine e Dimerore me Performance mund te ndikojne faktore te ndryshem por kryesisht ndikimi kryesor mund te vije nga faktore natyrore sic jane permbytjet, termetet, reshqitjet e medha masive te dherave, rreshqitje totale te trupit te rruges, reshje te shumta debore shoqeruar me temperatura shume te ulta, shembje ose demtime serioze urash, muresh mbajtese etj. Si rezultat i fenomeneve ekstreme te motit mund te krijohen situata emergjente te pazakonta te cilat nuk mund te menaxhohen nga Sipermarresi dhe nuk mund te perballohen nga kjo lloj kontrate. Ne keto raste mund te nevojiten nderhyrje te tjera si realizim investimesh, planifikime fondesh per zgjidhje te perkohshme, studime per zgjidhje definitive. Ne raste te tjera mund te nevojiten nderhyrje emergjente nga Shtabet e Emergjencave Civile, nga Ushtria, nga Institucione te tjera Shteterore, private etj. Ndikim ne mbarevajtjen e Kontrates mund te kene edhe implementimi i projekteve ne aksin rrugor qe mirembahet. Nese do te kete implementim projektesh te ndryshme Kontrata do te nderpritet ose do te shkurtohet gjatesia e mirembajtjes.

Nje pjese e akseve rrugore paraqiten ne gjendje shume te amortizuar si rezultat i mungeses se investimeve prej shume vitesh. Ne keto akse edhe siguria rrugore nuk eshte ne standartet e duhura. Me anen e kesaj kontrate nuk mund te zgjidhen te gjitha problemet e amortizimit, por vetem mund te permiresohen. Gjithashtu me anen e kesaj kontrate siguria rrugore nuk mund te arrije nivelet e kerkuara bashkekohore pasi do te nevojiten projekte te vecanta sinjalistike. Ne keto raste nga ana e Sipermarresit duhet te behen te gjitha perpjekjet qe brenda mundesive te kontrates te arrihet nje nivel dhe standart sa me i larte performance.

**QELLIMI I PUNES** : Kjo Kontrate eshte nje Kontrate Sherbimi dhe eshte nje Kontrate qe bazohet ne efektivitet dhe ne cfare kerkojne ne fund perdoruesit e rruges. Qellimi i Kontrates eshte arritja e niveleve dhe standarteve te caktuara dhe bazohen ne pagesa mujore per plotesimin e standarteve. Kontraktori duhet te arrije standartet e kerkuara qe rruga te mos kete gropa, te sigurohet rrjedhja e lire e ujit ne anet e rruges, tombinot te jene funksionale, ne rruge te mos kete aluvione, depozitime te ngurta inerte etj. Mirembajtja rutine konsiston ne shume detyra te ndryshme per tu kryer shpesh per te mbajtur funksionin e rruges. Per akset rrugore qe kane nevoje per mirembajtje dimerore nga Sipermarresi kerkohet te mos bllokohet aksi rrugor nga debora e ngricat, te sigurohet nje qarkullim sa me normal dhe pa rreziqe te automjeteve, te kryhen punime per pastrimin e debore, te mos lejohet formimi i akullit dhe ngricave (sa te jete e mundur) etj. Kontraktori do vendose, brenda struktures se tij organizative, nje Njesi Vete-Kontrolli te vacante te plotesuar pe personel te kualifikuar, detyra e te cilit eshte te monitoroje dhe mbeshtese verifikimin e shkalles se perputhjes me Nivelet e Cilesise se Sherbimit. Njesi e Vete-Kontrollit gjithashtu do kryeje ose organizoje prova dhe matje; pergatise, paraqese dhe dorezoje tek Manexheri i Rruges gjithe informacionin me qellim krijimin e dokumentacionit te percaktuar ne Specifikimet dhe manexhimin dhe mirembajtjen efektive te rrugeve. Njesia e vete-kontrollit do kryeje gjithashtu ose monitoroje, ne bashkepunim te ngushte nme Manexherin e Projektit, verifikimet mbi Nivelet e Cilesise se Sherbimit. Kontraktori do kryeje inspektime te

nivelit të shërbimit në rrjetin e rrugëve që përfshijnë gjithë aspektet që mund të vlerësohen me metoda të thjeshta, si inspektimet pamore dhe matjet e thjeshta që nuk kërkojnë pajisje komplekse. Çdo inspektim do dokumentohet nga një raport i shkurtër që përfshin informacionin e detajuar. Inspektimet do përfshijnë bashkë, kontroll dhe raportim mbi kushtet rrugore që lidhen me zërat e kontraktuar sipas një pagese njësi mujore.

**AFATI** : Kjo Kontratë ka një afat njëvjeçar. Zakonisht fillon në datën 1 të muajit pasardhës pas lidhjes së Kontrates. Menaxhimi dhe likuidimi i Kontrates bëhet me muaj. Gjate zbatimit ose në përfundim të Kontrates në rast nevojë mund të përdoret procedura negociimi për Shtesë Kontratë për të përballuar nevojat që mund të paraqiten.

**PLANIFIKIMI BUXHETOR** : Kontrata do të prokurohet me vlerë të plote për një vjet. Planifikimi vjetor do të bëhet në mënyrë proporcionale sipas shtrirjes kohore gjatë atij viti.

**BASHKEPUNIMI ME INSTITUCIONE TË TJERA** : Kontraktori duhet të ketë një bashkëpunim të ngushtë me Njësine Rajonale të Inspektoriatit të Qarkullimit Rrugor. Gjithashtu në rast emergjencash duhet të bashkëpunojnë me Shërbimet e Emergjencave dhe me Organet e Pushtetit Vendor.

**RAPORTIMI** : Kontraktori do të paraqesë një raport mujor pranë Autoritetit Kontraktor (Akt-Kontroll). Kontraktori do kryejë inspektime të nivelit të shërbimit në rrjetin e rrugëve që përfshijnë gjithë aspektet që mund të vlerësohen me metoda të thjeshta, si inspektimet pamore dhe matjet e thjeshta që nuk kërkojnë pajisje komplekse. Çdo inspektim do dokumentohet nga një raport i shkurtër që përfshin informacionin e detajuar. Inspektimet do përfshijnë bashkë, kontroll dhe raportim mbi kushtet rrugore që lidhen me zërat e kontraktuar sipas një pagese njësi mujore.

Kërkohet informacion i vazhdueshëm me Drejtorinë e Rajonit Jugor Gjirokastrë dhe bashkëpunim me Njësine Rajonale të Inspektoriatit të Qarkullimit Rrugor.

Në rastet e Mirembajtjeve Dimerore raportimi dhe informacioni do të jetë i vazhdueshëm.

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve:

Detyrat:

Shpërndarja:

Vendi i kryerjes së shërbimeve: aksi rrugor Berat – Corovodë 49.3 km.

**Shtojca 13**

[ *Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor* ]

**NJOFTIM STANDARD PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR<sup>1</sup>**

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar, Z/Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” .

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s’kualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme :

---

---

---

---

---

---

---

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RrPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi sic parashikohet në Kreun VII të LPP.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt

< **Emri** >



## Shtojca 14

[ Shtojcë për t'u plotësuar Autoriteti Kontraktor]

### FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

[Data\_\_\_\_\_]

Për: *[Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]*

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike *[Data]* *[Numri]*

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

|                                 |                        |
|---------------------------------|------------------------|
| 1. _____                        | _____                  |
| <i>Emri i plotë i shoqërisë</i> | <i>numri i NIPT-it</i> |

Vlera \_\_\_\_\_  
*(me numra dhe fjalë)*

|                                 |                        |
|---------------------------------|------------------------|
| 2. _____                        | _____                  |
| <i>Emri i plotë i shoqërisë</i> | <i>numri i NIPT-it</i> |

Vlera \_\_\_\_\_  
*(me numra dhe fjalë)*

Etj. \_\_\_\_\_

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

|                                 |                        |
|---------------------------------|------------------------|
| 1. _____                        | _____                  |
| <i>Emri i plotë i shoqërisë</i> | <i>numri i NIPT-it</i> |

|                                 |                        |
|---------------------------------|------------------------|
| 2. _____                        | _____                  |
| <i>Emri i plotë i shoqërisë</i> | <i>numri i NIPT-it</i> |

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë *[emri dhe adresa e ofertuesit të*

## Dokumentat standarde të tenderit

*shpallur fitues*] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej *[shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]*/pikët totale të marra *[\_\_\_\_\_]* është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *[emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit]* sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda \_\_\_\_\_ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej *[vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]*, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë \_\_\_\_\_

Ankesa: ka ose jo \_\_\_\_\_

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë \_\_\_\_\_

**[Titullari i autoritetit kontraktor]**

**Shtojca 15**

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër]

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM  
NË MARRËVESHJEN KUADËR**

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. \_\_\_\_\_
2. \_\_\_\_\_
3. \_\_\_\_\_

\* \* \*

Procedura e prokurimit: \_\_\_\_\_

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia, objekti , kohëzgjatja e kontratës etj]*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike *[Data]* *[Numri]*

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: oferta ekonomikisht më e favorshme çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatoren e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

|                                 |                        |
|---------------------------------|------------------------|
| 1. _____                        | _____                  |
| <i>Emri i plotë i shoqërisë</i> | <i>numri i NIPT-it</i> |

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera \_\_\_\_\_  
*(me numra dhe fjalë)*

|                                 |                        |
|---------------------------------|------------------------|
| 2. _____                        | _____                  |
| <i>Emri i plotë i shoqërisë</i> | <i>numri i NIPT-it</i> |

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera \_\_\_\_\_  
*(me numra dhe fjalë)*

Etj. \_\_\_\_\_

## Dokumentat standarde të tenderit

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* \_\_\_\_\_ *numri i NIPT-it* \_\_\_\_\_

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* \_\_\_\_\_ *numri i NIPT-it* \_\_\_\_\_

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* \_\_\_\_\_ *numri i NIPT-it* \_\_\_\_\_

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera \_\_\_\_\_ / Pikët totale të marra \_\_\_\_\_  
(me numra dhe fjalë)

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* \_\_\_\_\_ *numri i NIPT-it* \_\_\_\_\_

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera \_\_\_\_\_ / Pikët totale të marra \_\_\_\_\_  
(me numra dhe fjalë)

Etj. \_\_\_\_\_

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit], brenda \_\_\_\_\_ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë \_\_\_\_\_

Ankesa: ka ose jo \_\_\_\_\_  
(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë \_\_\_\_\_

**[Titullari i autoritetit kontraktor]**

## **KUSHTET E PËRGJITHSHME TE KONTRATES**

### **Shërbimet – Procedura e Hapur**

#### **Neni 1 Qëllimi**

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për kryerjen e Shërbimeve të prokuruar me anë të procedurës së hapur.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjane kushtet ose dispozitat e paraqitura në pjesë të tjera të kontratës.

Kushtet e kontratës, përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

#### **Neni 2 Përkufizime**

- 2.1 “Kontratë” do të thotë marrveshja e shkruar e lidhur midis Blerësit Publik dhe Kontraktuesit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjitet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 2.2 “Cmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet Kontraktuesit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.
- 2.3 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Shërbimet që Kontraktuesi do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.4 “Palë (t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.5 “Autoriteti Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate blen shërbimin. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.
- 2.6 “Kontraktues” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate shet Shërbimet.

- 2.7 “Shërbime” do të thotë të gjitha detyrat që do të kryhen nga Kontraktuesi sipas kontratës.
